

VENDIM
Nr. 110, datë 18.11.2014
PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE
PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR VITIN 2015

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 79, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes të energjisë elektrike”, ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015, si dhe relacionin e grupit të punës,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për aktivitetin e shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti